



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 23

Prishtinë, më 31.07.2018, me fillim në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Igor Simiq, kryetar i Komisionit Xhelal Sveçla dhe Danush Ademi, zëvendës të kryetarit. Fadil Beka, Rasim Selmanaj, Albert Kinolli, Mufera Serbica Shinik, Duda Balje dhe Veton Berisha, anëtarë .

Munguan: Kujtim Shala, Haxhi Shala, Zoran Mojsilović, Jasmina Zhivković, Sasha Milosavljević dhe Slobodan Petrović, anëtarë .

Pjesëmarrës tjerë: Senad Karaahmetović, (OSBE), Zijush Ahmeti, (KSZ) dhe Celal Iliaz, Drejtoria për Me dia dhe Marrëdhënie me Publikun

Zyrtarët për mbështetje të Komisionit: Natasha Prica Tishma dhe Drita Çarakxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Igor Simiq**, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua:

Rendi i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
 2. **Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 20.6. dhe 4.7.2018;**
 3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-058 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-036 për statistikën zyrtare të Republikës së Kosovës, me amendamente të Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;**
 4. **Të ndryshme.**
-
1. **Miratimi i rendit të ditës.**

Kryetari: Konstatoi se komisioni miratoi rendin e ditës, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalave nga mbledhjet e mbajtura më 20.6.2018 dhe 4.7.2018

Kryetari: Konstatoi se procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më: 20.6.2018 dhe 4.7.2018, miratohen njëzëri, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-058 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-036 për statistikën zyrtare të Republikës së Kosovës, me amendamente të Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Kryetari: Paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-058 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-036 për statistikën zyrtare të Republikës së Kosovës dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit Funkcional.

Pasi nuk pati diskutime shtesë, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë:

Rekomandim

P/ligji nr. 06/L-058 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-036 për statistikën zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe amendamente të propozuara nga Komisioni Funkcional nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

4. Të ndryshme

Nënkryetari Xhelal Sveçla: Në lidhje me zbatimin e Planit të punës së Komisionit për gjysmën e dytë të vitit dhe synimet për periudhën e ardhshme, është me rëndësi të definohen kuvendet komunale që do të vizitohen dhe të caktohen kornizat kohore për realizimin e këtyre aktiviteteve. Propozoi realizimin e vizitave në terren së paku në dy komuna, njëra me popullsi shumicë serbe dhe vizita tjetër me popullsi shumicë shqiptare.

Duda Balje: Si propozoi i saj ishte që të definohet në planin e punës për gjashëmujorin e dytë, me rastin e organizimit të vizitave në terren në kuvendet komunale, përveç kryetarit të komunës, të ftohen edhe drejtorët e zyrave për komuniteteve pran komunave.

Veton Berisha propozoi që Komisioni të organizojë punëtorin për rishqyrtimin e Planit të punës, ku do të inkorporoheshin disa ndryshime dhe plotësime, me qëllim të zbatimit të objektivave të Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 11:25

Përgaditur nga:

Njësia mbështetëse e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Igor Simiq